


Shënimet të
Seancës plenare
17-06-2022
asj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

Lënda: Nismë ligjore për amendimin e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

E nderuar Kryetare,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar”.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Erion BRACE

DEPUTET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ / 2022

PËR

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 48/2014 “PËR
PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET KONTRAKTORE E TREGTARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I I:

Në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar bëhen ndryshime dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 1, riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike ose nga ana e prodhuesve bujqësorë kundrejt ndërmarrjeve tregtare,

në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.”

Neni 2

Në nenin 3, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Pika 1, riformulohet me përmbajtje si vijon:

“1. “Veprimi juridik tregtar” është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, përfshirë dhe faturën tatimore, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare, nga njëra anë, dhe prodhuesve bujqësore apo autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.”

2. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si vijon:

3/1. “Prodhues bujqësor” është subjekti që zhvillon aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, pyjore dhe peshkimi, i cili në zbatim të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është i pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor.

Neni 3

Në nenin 4, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në titullin e nenit, pas fjalëve “veprime juridike ndërmjet” shtohen fjalët “prodhuesve bujqësorë.”.

2. Në paragrafin e parë, pas fjalës “kreditore” shtohen fjalët “përfshirë këtu dhe prodhuesin bujqësor”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA